

në periud-
za tejkallim
agesës së
mijë e 933
r të inka-
rajin gusht
241 mijë e
l të planit”,
r besimin
vazhdojë
tejkalohe
atimin në
341 mijë

HA Ditore

iale

eresuar
Mekaj, i
pasur
ionet e

odhues
Nexhat
e kua-
htë në
leverdi
duke e
legu.
ë fitim-
amilje.
e është
fundin
lem të
ja, i cili
ve dhe
ipas tij
idërsa
të in-
are.

Ditore

thënë Rexhepi. Kurse Selman
Ymeri, duke përkujtuar veprimtar-

©KOHA Ditore

Përrurohet shtegu “Via Ferrata” në Grykë të Rugovës

PEJË, 28 SHTATOR - Shtegu “Via Ferrata” në Grykë të Rugovës është përruruar të dielën.

Ky shteg është realizuar në dy faza dhe është financuar nga Komuna e Pejës, Trento nga Italia dhe “PPSE Swiss contact”, që kanë bërë të mundur realizimin e këtij projekti që ka kushtuar mbi 30 mijë euro dhe është i vetmi në rajon.

Gjatë përrurimit të shtegut, kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, tha se ky projekt i realizuar është projekt i qëndrueshëm i turizmit dhe një rast i mirë për promovimin e bjeshkëve të Rugovës. Ai tha se ky është një hap i madh për zhvillimin e turizmit në rajonin e Pejës dhe falënderoj shtetin italian dhe atë zviceran për kontributin e dhënë në realizimin e këtij projekti.

Projekt menaxheri i këtij shtegu, Virtyt Gacaferi, bëri të ditur se lartësia e këtij shtegu është mbi 300 metra dhe është një atraksion turistik, i cili ndoshta duket shumë i rrezikshëm, por ngjall shumë adrenalinë”. Secili person i cili është në gjendje normale fizike, që nuk ka frikë nga lartësia, mund ta vizitojë këtë shteg, ku do të marrin pajisjet e nevojshme dhe do të përcillen nga kujdestarët. Ne mendojmë që kjo është e mirë për sportin, por edhe për zhvillimin e turizmit”, tha

Gacaferi i cili shtoi se kjo do të ndikojë edhe në të hyrat e Komunës nga vizitat e turistëve që i bëjnë këtij rajoni.

Ardian Krasniqi si anëtar i ri i grupit “Merimanga” të Pejës ishte vizitori i këtij shtegu të sapohapur. “Më së shumt më la përshtypje siguria e krijuar nga pajisjet dhe pamjet e mrekullueshme që nuk i kisha parë ndonjëherë”, tha alpinisti Krasniqi.

Teuta Rexhepi ishte femra e parë që vizitoi shtegun “Via Ferrata”, e cila për herë të parë viziton një shteg të tillë si alpiniste. “E pata të vështirë një herë të bindem, por më pas gjithçka shkoi shumë mirë. Siguria ishte e plotë dhe nuk kishte hapësirë për tremë, një përvojë e papërshkrueshme”, tha Rexhepi. Realizimin e këtij projekti e përrshëndeti edhe komandanti i KFOR-it, kolonel Migeli, i cili tha se ky është një projekt i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit dhe pas përrurimit do ta vizitojë këtë shteg. Pas përrfundimit të ceremonisë së hapjes zyrtare, kryetari i Pejës me disa anëtarë të kabinetit të tij së bashku me komandantin e KFOR-it, kolonel Migeli, të shoqëruar me një ekip të “Merimangave” të Pejës morën rrugë për ta vizituar shtegun “Via Ferrata”.

Shkodran Nikçi

©KOHA Ditore